

Kina edhe një herë ka ndaluar Ramazanin në pjesën e largët perëndimore të Xinjiang, për anëtarët myslimanë të partisë, shërbyesit civilë, studentët dhe mësuesit.

Myslimanët e kësaj pjese që njihen si pakica ujqure, janë urdhëruar nga autoritetet e vendit që gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit të mos agjërojnë, raporton The Independent.

Lideri i ujqurëve, Dilxat Raxit, lëvizjen e Kinës e sheh si përpjekje për të kontrolluar besimin e tyre islam, dhe paralajmëroi se kufizimet do të detyrojnë ujqurët t'i rezistojnë sundimit të qeverisë kineze.